

---

# STATUT

## I

### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "MANASTIRI RESORT"

Sot më datë 16/11/2021, në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" - i ndryshuar, themelohet shoqëria "Manastiri Resort" SHPK, veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas këtij Statuti.

#### Neni 1

##### Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

#### Neni 2

##### Ortakët e shoqërisë

Ortakët e shoqërisë janë:

- **Shoqëria "ANDI." SHPK**, me nr. NUIS J66903237U, me seli në adresën: Lagjja Pavaresia, Rruga Pelivan Leskaj, Pallati Andi 3, Kati 2, Vlorë, përfaqësuar nga **Z. Florian Mitrushi**;
- **Shoqëria "FINMAN" SHPK**, me nr. NUIS L62405030K, me seli në adresën: Sheshi Italia, Arena Center, Seksioni D, Kati 5, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Idajet Ismailaj**.

#### Neni 3

##### Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.



---

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 5**  
**Selia**

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga Dervish Hima, Arena Center, Seksioni B/C, kati 5, Tirane, Shqipëri.**
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**Neni 6**  
**Dokumentet e shoqërisë**

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
- a) *numrin unik të identifikimit;*
  - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
  - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
  - ç) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
  - d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

**Neni 7**  
**Objekti i veprimtarisë**

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

---



- 
- Projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim e një kompleksi turistik, një strukture hotelerie dhe e objekteve turistike;
  - Shitja, dhënia me qira dhe disponimi në çdo lloj forme i objekteve me destinacion rezidencial;
  - Ofrimi i shërbimeve të hotelieri-turizmit në zonën e Sarandës, si dhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur;
  - Investim në ndërtimin e vilave, banesave dhe hoteleve. Shitje dhe blerje pronash dhe çdo lloj ndërtimi të realizuar ose jo nga vetë shoqëria;
  - Përgatitja e planeve të zhvillimit për zonat e zgjedhura; Hartimi i projekteve për planet e zhvillimit dhe për çdo lloj tjetër investimi në fushën e real estate. Mirëmbajtja e objekteve dhe infrastrukturës;
  - Menaxhimi i hoteleve; Menaxhim bar-restoranti; Menaxhim i sipërfaqes së plazhit. Në përmbushje të objektit më sipër, shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet e nevojshme, të tilla si, por pa u kufizuar në importin dhe eksportin e pajisjeve, mallrave të ndryshëm, lëndës së parë, artikujve industriale të ndryshëm përfshi produkte ushqimore të çdo lloji.
  - Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
  - Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.
- 7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

## **Neni 8**

### **Kapitali themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **1, 000, 000 (një milion) lekë**.
- 8.2 Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota/pjesë me vlerë nominale **500,000(pesëqind mije) lekë** secila, të cilat zotërohen si më poshtë:
- Ortaku shoqëria "ANDI." SHPK zotëron 1 kuotë/pjesë që përfaqëson 50 % të kapitalit, me vlerë 500,000 lekë;
  - Ortaku shoqëria "FINMAN" SHPK zotëron 1 kuotë/pjesë që përfaqëson 50 % të kapitalit, me vlerë 500,000 lekë.

---



---

## Neni 9

### Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe shoqerive të lidhura me to.
- 9.2 Në rast se njëri prej ortakëve, ka qëllim të shesë apo të transferojë një pjesë apo të gjitha kuotat e tij ("Ofruesi") tek persona të tjerë të tretë, ai duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim mbi qëllimin për shitjen, ortakun tjetër ("Ortaku Tjetër"), me letër rekomande me kthim përgjigje. Në njoftim ("Njoftimi i Transferimit"), Ofruesi duhet të përcaktojë (i) numrin e kuotave që do të shesë/transferojë, (ii) çmimin për kuotë dhe (iii) emrin e palës së tretë blerëse ("Blerësi"). E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje ("Kuotat e Ofuara").
- 9.3 Brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e Njoftimit të Transferimit, Ortaku Tjetër duhet t'i komunikojë Ofruesit synimin e tij për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se Ortaku Tjetër nuk përgjigjet në afatin e caktuar, do të konsiderohet që ai ka hequr dorë nga e drejta e tij e parablerjes.
- 9.4 Në rast se Ortaku Tjetër ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrën e sipërcituar, transferimi i Kuotave të Ofuara dhe pagesa e çmimit të blerjes do të bëhet sipas kushteve të Njoftimit të Transferimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga përfundimi i afatit për ushtrimin e të drejtës së parablerjes përcaktuar më lart.
- 9.5 Në rast se Ortaku Tjetër nuk blen Kuotat e Ofuara dhe/ose nuk pranon të blejë Kuotat e Ofuara në mënyrat e caktuara më lart, Ofruesi ka të drejtë t'i transferojë Blerësit Kuotat e Ofuara, në përputhje me kushtet e Njoftimit të Transferimit. Transferimi i kuotave dhe pagesa e çmimit të shitjes do të bëhet në përputhje me kushtet e Njoftimit të Transferimit dhe brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune nga përfundimi i afatit për ushtrimin e të drejtës së parablerjes përcaktuar më lart ("Afati i Mbylljes"). Në rast se transferimi i kuotave nuk kryhet brenda Afatit të Mbylljes ose propozohet të përfundohet në kushte më të favorshme se ato të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit, Ofruesi do të jetë i detyruar ta nisë nga e para të gjithë procedurën e së drejtës së parablerjes.
- 9.6 Sa më sipër është parashikuar nuk do të zbatohet në rast transferimi të kuotave nga ortakun tek një shoqëri e lidhur me të. Në kuptim të këtij neni Shoqëri të lidhura do të konsiderohen:
- (i) një shoqëri që direkt ose indirekt kontrollon ortakun ofrues;
  - (ii) një shoqëri që kontrollohet direkt ose indirekt nga ortakun ofrues;



---

(iii) ortakı ofrues dhe shoqëria që do t'i transferohet kuota janë nën kontrollin e së njëjtës shoqëri;

(iv) një shoqëri që është nën influencën e ortakut ofrues sipas nenit 207 të ligjit Nr. 9901 datë 14.03.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

## **Neni 10**

### **Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

## **Neni 11**

### **Asambleja e Ortakëve**

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
- ndryshimi i dispozitave të statutit,
  - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
  - emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
  - miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
  - emërimi dhe shkarkimi i drejtoreve nën varesinë direkte të Administratorit;
  - miratimi i llogarive vjetore (bilancit);
  - shit-blerjen e pasurive të paluajtshme;
  - miratimin e blerjeve, shitjeve, nënshkrimit të kontratave me palë të treta për punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër për një vlerë mbi 50 000 EUR (pesedhjetë mijë Euro);

- 
- vendosjen e barrëve, hipotekës, pengut, dhënien e dorëzanive apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
  - blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
  - miratimin e rregulloreve të brendshme të Shoqërisë;
  - ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,
  - mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.
- 11.3 Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

## **Neni 12**

### **Vendimmarrja**

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të

---



---

procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

### **Neni 13**

#### **Mungesa e vendimmarrjes**

13.1 Në rast të mungesës së unanimitetit në vendimmarrje, mos arritjes së kuorumit të nevojshëm të përcaktuar në këtë statut, ose për shkak se një ortak abstenon të votojë një çështje të rendit të ditës, një mbledhje e dytë e përgjithshme e ortakëve do të thirret brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e mbledhjes së parë.

Ortakët do të përpiqen me mirëbesim të gjejnë një zgjidhje për çështjen gjatë periudhës 7 (shtatë) ditore deri në realizimin e mbledhjes së dytë me të njëjtin rend dite.

13.2 Në rast se:

- a. *nuk gjendet asnjë zgjidhje në Mbledhjen e Dytë të Përgjithshme, ose*
- b. *asnjë vendim nuk mund të merret për shkak të mungesës së kuorumit, ose*
- c. *një Ortak abstenon nga votimi,*


secili prej ortakëve do të autorizojë CEO-n e tij (administratorin) me qëllim që brenda një periudhe kohore 10 ditë kalendarike nga data e mbledhjes së dytë, të gjendet një zgjidhje e mundshme me mirëkuptim, për çështjen që ka sjellë bllokimin në vendimmarrje.

CEO-t e të dy Ortakëve do të bëjnë përpjekjet më të mira për të gjetur një zgjidhje për çështjen dhe për të arritur një vendim të përbashkët për këtë çështje brenda afatit të sipërcituar kohor. Ortakët dhe shoqëria do të pranojnë dhe zbatojnë vendimin e përbashkët të CEO-ve.

13.3 Në rast se CEO-t nuk gjejnë një zgjidhje brenda periudhës së lartpërmendur, secili Ortak do të ketë të drejtë t'i dërgojë një njoftim me shkrim Ortakut tjetër, me qëllim që bashkërisht të caktojnë me mirëkuptim dhe brenda 7 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të sipërcituar 10 ditor, një Arbitër ose Ndërmjetës. Arbitri/Ndërmjetësi duhet të shqyrtojë çështjen për të cilën vendimmarrja është bllokuar si dhe të japë një vendim përfundimtar, brenda një afati kohor 30 ditë kalendarike nga data e caktimit të tij. Vendimi i arbitrit/ndërmjetësit është përfundimtar dhe i detyrueshëm për ortakët dhe shoqërinë.

13.4 Në rast se ndonjëri prej ortakëve nuk pranon që çështja që ka shkaktuar bllokimin në vendimmarrje të shqyrtohet nga arbitri/ndërmjetësi, ai menjëherë duhet të informojë për këtë me shkrim Ortakun tjetër duke i dërguar një Njoftim për Blerjen /Shitjen e

---



---

Kuotave. Njoftimi për blerjen/shitjen e kuotave duhet t'i dërgohet njëkohësisht edhe Audituesit të shoqërisë.

13.5 Audituesi i shoqërisë, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të blerjes / shitjes dërguar nga Ortakët (ose njëri prej tyre), duhet të njoftojë këta të fundit për një datë mbledhje, në të cilën secili prej Ortakëve do të dorëzojë pranë Audituesit të Shoqërisë një zarf të mbyllur dhe të vulosur ("zarf i vulosur") në të cilin duhet të specifikojë një çmim për blerjen e të gjitha kuotave në pronësi të Ortakut tjetër. Duke vlerësuar faktin që ortakët në shoqëri mund të zotërojnë përqindje të ndryshme kapitali, çmimi që ata do të përcaktojnë në zarf do të konsiderohet si një çmim për vlerën nominale të një kuote. Për qëllime të finalizimit të kësaj procedure, ortakët do të konsiderojnë sikur kapitali i shoqërisë është i ndarë në 100 kuota dhe çmimi që Ortakët përcaktojnë në zarf, përfaqëson vlerën që secili prej tyre propozon për blerjen e një kuote. Në datën e caktuar prej audituesit në njoftimin që ky i fundit u ka dërguar ortakëve, audituesi i shoqërisë pas dorëzimit të zarfeve nga përfaqësuesit e autorizuar të ortakëve, do të hapë zarfet po në prani të përfaqësuesve si dhe do të deklarojë menjëherë çmimin më të lartë të ofruar për kuotë. Gjatë mbledhjes së sipërcituar, Administratori i shoqërisë kujdeset që të mbahet një procesverbal i cili në fund të mbledhjes do duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar nga secili prej ortakëve, audituesi dhe administratori.

13.6 Pas kësaj, Ortaku i cili ofroi çmimin më të lartë (si vlerë nominale për kuotë) për kuotat e Ortakut tjetër, ka të drejtë të zgjedhë një nga opsionet e mëposhtme:

- (i) *të blejë kuotat e Ortakut tjetër me çmimin e deklaruar në zarfin e vulosur prej atij vetë, pra me çmimin më të lartë ose,*
- (ii) *të shesë kuotat e tij Ortakut tjetër, me çmimin e deklaruar në zarfin e vulosur nga Ortaku tjetër.*

Blerja ose shitja duhet të përfshijë të gjitha kuotat e Ortakut tjetër dhe nuk mund të ketë të bëjë vetëm me një pjesë të kuotave të Ortakut tjetër.

13.7 Në rast se një Ortak nuk depoziton një zarf të vulosur, Ortaku tjetër do të ketë opsionin, në diskrecionin e tij të vetëm, për të:

- (i) *blerë të gjitha kuotat e Ortakut tjetër me çmimin e deklaruar në zarfin e vulosur prej tij, ose*
- (ii) *për të shitur të gjitha kuotat e tij Ortakut tjetër me çmimin e deklaruar në zarfin e vulosur prej tij.*

Ortaku tjetër ka detyrimin të shesë kuotat e tij Ortakut që depozitoi zarfin ose të blejë kuotat e këtij të fundit me çmimin e deklaruar në zarfin e vulosur, në përputhje me zgjedhjen

---



- 
- që do të bëjë Ortaku që depozitoi zarfin. Në rast se asnjë nga Ortakët nuk depoziton një zarf të vulosur, Shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.
- 13.8 Në çdo rast, pronësia mbi kuotat do të transferohet vetëm me pagimin e çmimit të blerjes së kuotave.
- 13.9 Në çdo rast të aplikimit të nenit 13.2/13.3/13.4/13.6/13.7 duhet të vërtetohet nga administratori dhe nga audituesi i shoqërisë që të gjithë ortakët e shoqërisë me kuote mbi 5% të shoqërisë janë njoftuar dhe kanë marrë njoftimin zyrtar nëpërmjet postes rekomande dhe njoftimet janë dorëzuar në adresën e ortakut të shoqërisë.

#### **Neni 14**

##### **Administratori**

- 14.1 Administratori emërohet për një mandat 1 (një) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 14.2 Administratori i parë i shoqërisë është: **Z.Gerold Tola**, shtetas shqiptar lindur me 11/01/1992 në Perrenjas, me numer letërnjoftimi 036240028 dhe numer personal J20111017R.
- 14.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.
- 14.4 Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
- 14.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

#### **Neni 15**

##### **Kontrolli financiar**

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

---



## Neni 16

### Viti financiar

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 16.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

## Neni 17

### Bilanci dhe Dividendët

- 17.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 17.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

## Neni 18

### Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

## Neni 19

### Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në katër ekzemplarë në gjuhën shqipe.

## ORTAKËT E SHOQËRISË

### ANDI. SHPK

Përfaqësuar nga:

**Z. Florian Mitrushi**

*Florian Mitrushi*

Data 16/11/2021



### FINMAN SHPK

Përfaqësuar nga:

**Z. Idajet Ismailaj**

*Idajet Ismailaj*

**FINMAN**  
FINANCIAL MANAGEMENT GROUP